



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 06/2025 PËR TRAJNIMIN DHE
TESTIMIN E DETYRUESHËM, SI DHE CERTIFIKIMIN E
INSPEKTORËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS¹**

¹ Rregullore (QRK) nr. 06/2025 për Trajnimin dhe Testimin e Detyrueshëm, si dhe Certifikimin e Inspektorëve të Republikës së Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 261-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/261, të datës 05.06.2025.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafin 7 të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, nenit 9, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, nenit 8, paragrafin 4, nën-paragrafin 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenin 78, paragrafin 6, nën paragrafin 6.2 të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 06/2025 PËR TRAJNIMIN DHE TESTIMIN E DETYRUESHËM, SI DHE CERTIFIKIMIN E INSPEKTORËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e programit të trajnimit të detyrueshëm për inspektorët, përmbajtjen, kushtet, kriteret, mënyrën dhe procedurën e organizimit të trajnimit dhe testimit të detyrueshëm, si dhe certifikimit të inspektorëve në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë inspektorët e punësuar në administratën shtetërore dhe në nivel komunal në tërë Republikën e Kosovës, përveç inspektorëve të organeve inspektuese të përjashtuara nga fushëveprimi i Ligjit përkatës për Inspektimet.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin vijues:

1.1. **ZIP** – nënkupton Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm;

1.2. **IKAP** – nënkupton Instituti i Kosovës për Administratë Publike.

2. Termat tjerë të përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me termat e përdorur në Ligjin përkatës për Inspektimet dhe Ligjin përkatës për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

3. Përdorimi i emrit në njërën gjini, nënkupton edhe gjininë tjetër.

Neni 4

Përgjegjësia institucionale për trajnimin, testimin dhe certifikimin e inspektorëve

1. Institucioni përgjegjës për organizimin e trajnimit, testimin dhe certifikimin të inspektorëve është IKAP pranë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike, dhe ZIP pranë Zyrës së Kryeministrit.
2. Institucioni përgjegjës për aprovimin e përmbajtjes së moduleve të trajnimit të detyrueshëm për inspektorë është ZIP.
3. Institucioni përgjegjës për lëshimin e certifikatave për inspektorë është IKAP, dhe ZIP.

KAPITULLI II TRAJNIMI I DETYRUESHËM PËR INSPEKTORË

Neni 5

Përmbajtja e trajnimit të detyrueshëm

1. Trajnimi i detyrueshëm zhvillohet në pajtim me modulet e trajnimit, të cilat hartohen nga trajnerët e certifikuar për trajnimin e detyrueshëm të inspektorëve dhe për nga aspekti përmbajtësor miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm i ZIP, sipas kornizave të përgjithshme dhe kriterëve të përcaktuara nga IKAP.
2. Modulet e trajnimit të detyrueshëm për inspektorë përfshijnë elaborimet e temave të përgjithshme vijuese:
 - 2.1 korniza e përgjithshme normative mbi inspektimet;
 - 2.2. inspektimi i bazuar në rrezik; dhe
 - 2.3. procedurat dhe praktikën e inspektimeve.
3. Tërë trajnimi me temat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, zhvillohet në kohëzgjatje prej pesë (5) ditësh.
4. Përmbajtja e programit të trajnimit të detyrueshëm për inspektorë përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Kushtet për trajnimin e detyrueshëm

1. Të gjithë inspektorët që janë në marrëdhënie pune ekzistuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm.
2. Inspektori i cili është në periudhë të punës provuese ka përparësi për t'iu nënshtuar trajnimit të detyrueshëm.
3. Institucionet që pranojnë inspektorë të rinj, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e nënshkrimit të akt-emërimit, dërgojnë listën e inspektorëve të rinj tek ZIP.

Neni 7

Trajnerët për ofrimin e trajnimit të detyrueshëm dhe trajnimi i trajnerëve

1. Trajnimi i detyrueshëm për inspektorë ofrohet nga trajnerët e certifikuar nga IKAP.
2. Trajnerët që ofrojnë trajnimin e detyrueshëm të inspektorëve trajnohen nga trajneri i trajnerëve i cili përzgjedhet përmes shpalljes publike, dhe duhet të plotësojë edhe kushtet e mëposhtme si vijon:
 - 2.1. të jetë i diplomuar në fushat: Juridik, Ekonomi, Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale apo Administratë Publike;
 - 2.2. të ketë të kryer të paktën nivelin master të studimeve, e preferuar;
 - 2.3. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore për shkelje të rëndë në sektorin publik;
 - 2.4. të mos jetë i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje;
 - 2.5. të ketë njohuri për metodologjinë e bazuar në rrezik; dhe
 - 2.6. të ketë përvojë pune profesionale së paku dhjetë (10) vjeçare, përvojë si trajner, si dhe njohuri në fushën e inspektimeve.
3. Kandidatët për t'iu nënshtruar trajnimit për trajnerë dhe për t'u certifikuar si trajnerë të inspektorëve, përzgjedhen në pajtim me procedurat e përcaktuara në aktin përkatës që rregullon angazhimin e trajnerëve në IKAP. Kandidatët për trajnerë është e preferueshme të kenë njohuri në fushën e inspektimeve.
4. Moduli i trajnimit për trajnerë hartohet nga trajneri i trajnerëve dhe aprovohet nga ZIP dhe IKAP.
5. Vetëm pas certifikimit si trajnerë nga IKAP, trajnerët mund të ftohen për zhvillimin e trajnimit të detyrueshëm për inspektorë.
6. Trajnerët e certifikuar ftohen nga IKAP për të zhvilluar trajnimin e detyrueshëm sipas rezultateve të fituara nga vlerësimi përfundimtar i trajnerit. Nëse rezultatet e dy apo më shumë kandidatëve për trajnerë janë të njëjta, atëherë ata ftohen sipas radhës alfabetike.

Neni 8

Mënyra e organizimit të trajnimit të detyrueshëm

1. Trajnimi i detyrueshëm organizohet në IKAP.
2. IKAP vendos për numrin e pjesëmarrësve që mund të marrin pjesë në çdo trajnim të organizuar.

3.Në fillim të trajnimit të detyrueshëm, pjesëmarrësit në trajnim njoftohen nga përfaqësuesi i IKAP mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre për trajnimin, testimin dhe certifikimin e tyre që derivojnë nga kjo Rregullore dhe legjislacioni në fuqi.

4.Me rastin e përfundimit të trajnimit të detyrueshëm, pjesëmarrësit në trajnim plotësojnë formularin e vlerësimit të trajnimit i cili përcaktohet nga IKAP.

5.Pjesëmarrja e inspektorëve në trajnimin e detyrueshëm, vërtetohet përmes listës së pjesëmarrjes të përgatitur nga IKAP.

Neni 9

Plani vjetor i trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme

1.IKAP dhe ZIP, hartojnë dhe mirëmbajnë planin vjetor të trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme për inspektorë.

2.Planin vjetor i trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme për inspektorë i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ndër tjerash përmban edhe datat e planifikuara të trajnimeve të detyrueshme për inspektorë që organizohen nga IKAP.

3.Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, planin vjetor i trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme për inspektorë përmban së paku tri (3) data të ndryshme për organizimin e trajnimeve dhe tri (3) data të tjera për organizimin e testimeve të detyrueshme në çdo gjashtë (6) muaj. Pas përfundimit të trajnimit dhe testimit për të gjithë inspektorët aktualë, datat e trajnimeve dhe testimeve përcaktohen sipas nevojës.

4.Datat e mbajtjes së trajnimeve të detyrueshme vendosen para datave të mbajtjes së testimeve të detyrueshme.

Neni 10

Procedura e organizimit të trajnimit të detyrueshëm

1.Në pajtim me planin vjetor të trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme, IKAP, në bashkëpunim me ZIP, publikojnë në ueb faqet e tyre respektive thirrjen publike për trajnim dhe testim, duke përfshirë datat e sakta të trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme për inspektorë. Thirrja publike dërgohet nga ZIP tek të gjitha organet inspektuese.

2.Thirrja publike për datat e trajnimeve dhe testimeve të detyrueshme shpallet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para mbajtjes së trajnimit të detyrueshëm.

3.Organet inspektuese dërgojnë në ZIP listat e inspektorëve që do të marrin pjesë në trajnimin e detyrueshëm së paku dhjetë (10) ditë para fillimit të mbajtjes së trajnimit.

4.Lista e kandidatëve të përzgjedhur për trajnim dhe testim të detyrueshëm publikohet në faqen zyrtare të internetit të ZIP dhe IKAP së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së trajnimit të detyrueshëm, së bashku me datat dhe orarin e mbajtjes së trajnimit dhe testimit të detyrueshëm. Të gjithë kandidatët njoftohen nga IKAP përmes adresës elektronike zyrtare.

5.Në rast se një inspektor që përfshihet në listë për trajnimin e detyrueshëm nuk e vijon trajnimin në datat e caktuara, ai ka mundësi të përfshihet përsëri në listë vetëm dy (2) herë të tjera brenda gjashtë (6) muajve.

6.Përrjashtimisht paragrafit 5 të këtij neni, nëse inspektori ka arsye objektive për të cilat nuk mund t'a vijojë trajnimin, të vërtetuara nga njësia e burimeve njerëzore ku është i punësuar inspektori, atëherë njësia e burimeve njerëzore sigurohet t'a dërgojë për përfshirje në listë jo më larg se afati i përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 18 të kësaj rregulloreje.

7.Mungesa e pjesëmarrjes së inspektorëve, për të tretën herë pas përfshirjes në listën sipas paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni dhe mos vërtetimi i arsyes objektive sipas paragrafit 6 të këtij neni, rezultojnë në moskalimin e testimit të detyrueshëm brenda afatit ligjor dhe, rrjedhimisht, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.

KAPITULLI III TESTIMI I DETYRUESHËM PËR INSPEKTORË

Neni 11

Përmbajtja e testimit të detyrueshëm

1.Testimi i detyrueshëm përgatitet në formë të pyetjeve me zgjidhje të shumëfishta, nga temat e shtjelluara gjatë trajnimit të detyrueshëm.

2.Testimi i detyrueshëm përmban pesëdhjetë (50) pyetje me nga dy (2) pikë secila.

Neni 12

Kushtet për testimin e detyrueshëm

1.Për t'iu nënshtruar testimit të detyrueshëm, inspektori duhet të marrë pjesë në së paku (80%) të kohës në trajnimin e detyrueshëm, e cila evidentohet nga IKAP.

2.Inspektori i cili është në periudhë të punës provuese ka përparësi për t'iu nënshtruar testimit të detyrueshëm.

Neni 13

Procedura e organizimit të testimit të detyrueshëm

1.Testimi i detyrueshëm realizohet nga IKAP dhe zhvillohet përmes sistemit elektronik i cili sigurohet dhe mirëmbahet nga IKAP.

2.Në pajtim me disponueshmërinë e hapësirës, IKAP vendos për numrin e personave që mund të marrin pjesë në çdo testim të organizuar dhe e njofton ZIP.

3.Banka e pyetjeve të mundshme të testimit të detyrueshëm përgatitet bashkërisht nga trajnerët.

4.Pyetjet e testimit përzgjidhen nga banka sipas paragrafit 3 të këtij neni, nga Komisioni prej tre (3) anëtarësh i themeluar nga ZIP, jo më herët se tridhjetë (30) minuta para fillimit të testimit të detyrueshëm.

5.Jo më vonë se dy (2) ditë pas përfundimit të testimit të detyrueshëm, kandidatët njoftohen me rezultatet e testimit, dhe IKAP harton raport për rezultatet e testimit dhe e publikon në ueb faqe dhe e njofton ZIP.

KAPITULLI IV CERTIFIKIMI I INSPEKTORËVE

Neni 14 Kushtet për certifikim

1.Inspektori i cili ka marrë pjesë në trajnimin e detyrueshëm dhe ka arritur të grumbullojë së paku gjashtëdhjetë përqind (60%) të pikëve në testimin e detyrueshëm, certifikohet si inspektor.

2.Inspektori i cili nuk ka arritur të grumbullojë së paku gjashtëdhjetë përqind (60%) të pikëve herën e parë, i ofrohet mundësia që t'i nënshtrohet përsëri testimit, pa detyrimin për t'ju nënshtuar përsëri trajnimit, edhe dy (2) herë të tjera brenda periudhës prej gjashtë (6) muajsh. Nëse inspektori nuk grumbullon gjashtëdhjetë përqind (60%) të pikëve, në njëherë nga tri (3) mundësitë e testeve brenda gjashtë (6) muajve, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.

3.Inspektori i cili është në periudhën e punës provuese dhe nuk arrin të grumbullojë së paku gjashtëdhjetë përqind (60%) të pikëve të testimit të detyrueshëm herën e parë, i ofrohet mundësia që t'i nënshtrohet përsëri testimit, pa detyrimin për t'ju nënshtuar përsëri trajnimit, edhe dy (2) herë të tjera brenda periudhës provuese. Nëse inspektori që është në periudhën e punës provuese, edhe në herën e tretë (3) të testimit nuk arrin të grumbullojë së paku gjashtëdhjetë përqind (60%) të pikëve të testimit të detyrueshëm, përbën shkak për moskonfirmim të marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

4.Moskonfirmimi i marrëdhënies së punës dhe lirimi nga shërbimi civil, bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

5.Në rast të moskalimit të testit për herë të tretë, ZIP njofton Inspektoratin përkatës, pjesë e së cilit është inspektori.

Neni 15 Mënyra e organizimit të certifikimit

1.Inspektorët të cilët kanë kaluar testin sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje, pajisjen me certifikatë nga ana e IKAP dhe ZIP. Drejtori i Përgjithshëm i IKAP dhe Inspektori i Përgjithshëm i ZIP i nënshtrojnë të gjitha certifikatat të cilat dorëzohen tek inspektorët e certifikuar në mënyrë ceremoniale.

2. IKAP përgatitë të gjitha certifikatat e inspektorëve të cilat evidentohen në një regjistër që mirëmbahet nga IKAP.

3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, informatat e regjistrit të certifikatave të inspektorëve shkëmbehen në baza të rregullta gjashtë (6) mujore me ZIP dhe çdo herë tjetër sipas kërkesës së parashtruar nga ZIP.

4. Pajisja e inspektorëve me certifikatë, bëhet jo më vonë se njëzet (20) ditë pas publikimit të rezultateve të testimit të detyrueshëm.

Neni 16 **Përmbajtja e certifikatës**

1. Certifikata për inspektorë sipas nenit 15 të kësaj Rregulloreje, përmban:

- 1.1. emrin dhe mbiemrin e inspektorit të certifikuar;
- 1.2. shenjat identifikuese (logo apo stemë) të Republikës së Kosovës, të ZIP dhe IKAP;
- 1.3. pas emrit dhe mbiemrit të inspektorit, mbishkrimin “inspektor i certifikuar”;
- 1.4. nënshkrimet përkatëse të Inspektorit të Përgjithshëm të ZIP dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të IKAP;
- 1.5. kodin përkatës të certifikatës; dhe
- 1.6. në pjesën e poshtme të certifikatës, mbishkrimin “verifikimi i autenticitetit të kësaj certifikate mund të bëhet pranë IKAP”.

Neni 17 **E drejta e ankesës**

Kundër vendimit për moskonfirmim të marrëdhënies së punës apo lirim nga shërbimi civil, pala e pakënaqur mund të parashtrorë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas përcaktimeve në Ligjin për Zyrtarët Publikë.

KAPITULLI V **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 18 **Periudha e certifikimit të inspektorëve**

1. Trajnimi dhe testimi i detyrueshëm i të gjithë inspektorëve aktualë, do të bëhet brenda njëzet e katër (24) muajve nga data e publikimit të thirrjes së parë publike për trajnim të detyrueshëm.

2. Trajnimi dhe testimi i detyrueshëm i të gjithë inspektorëve në periudhë provuese, do të bëhet brenda gjashtë (6) muajve të periudhës provuese.

Neni 19 **Përgjegjësia për zbatim**

Mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj Rregulloreje në vazhdimësi e bëjnë ZIP, IKAP dhe të gjitha organet inspektuese.

Neni 20 **Trajnimet e tjera**

Organet inspektuese mund të organizojnë trajnime të tjera të vazhdueshme për inspektorë në fushat sektoriale të inspektimeve që ata mbulojnë.

Neni 21 **Epërsia e normave**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje mbizotërojnë dispozitat tjera të akteve nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e trajnimit, testimit dhe certifikimit të inspektorëve.

Neni 22 **Shtojcat**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është Shtojca Nr. 1 – Programi i trajnimit të detyrueshëm për inspektorë.

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

22 shtator 2025

Shtojca Nr. 1. Programi i trajnimit të detyrueshëm për inspektorë

Titulli i trajnimit	Kualifikimi profesional i inspektorëve
Grupet e synuara	Inspektorët e administratës shtetërore dhe të nivelit lokal, përjashtimisht inspektorëve të përcaktuar me Ligjin përkatës për Inspektime.
Kushti për pjesëmarrje	Kushti që duhet plotësuar për t'iu nënshtruar trajnimit të detyrueshëm për inspektorë është marrëdhënia e punës si inspektor në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
Qëllimi	Qëllimi kryesor i trajnimit është kualifikimi profesional i inspektorëve dhe certifikimi i tyre.
Objektivat	Trajnimi i detyrueshëm për inspektorë synon arritjen e objektivave vijuese: - të kuptuarit e kornizës së përgjithshme normative mbi inspektimet; - të kuptuarit e inspektimit të bazuar në rrezik; dhe - të kuptuarit e procedurave dhe praktikave të inspektimit.
Përmbajtja e trajnimit (temat)	Modulet e trajnimit të detyrueshëm për inspektorë përmbajnë temat vijuese: - korniza e përgjithshme normative mbi inspektimet, me kohëzgjatje prej dy (2) ditësh; - inspektimi i bazuar në rrezik, me kohëzgjatje prej dy (2) ditësh; si dhe - procedurat dhe praktikave të inspektimit, me kohëzgjatje prej një (1) ditë.
Kohëzgjatja	Pesë (5) ditë në total.
Metodat	Ligjerata, diskutime grupore dhe analiza të rasteve.
Institucionet përgjegjëse	Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm pranë Zyrës së Kryeministrit, dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike pranë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

Vendi dhe adresa ku zhvillohet trajnimi	Trajnimi i detyrueshëm për inspektorë zhvillohet në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.
Numri kontaktues dhe adresa elektronike	Instituti i Kosovës për Administratë Publike Personi kontaktues: _____ Numri i telefonit: _____ Adresa elektronike: _____